



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 21 Datë 18.02.2013

MBI

KERKESEN PER MIRATIM TE TABELAVE TE KLASIFIKIMIT TE PERSONELIT DHE STRUKTURES SE PAGAVE PER PUNONJESIT E CEZ SHPERNDARJE SH.A (NE ADMINISTRIM TE PERKOHSHEM)

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, dhe 9, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Vendimin nr. 5, date 21.01.2013, “Për vendosjen e shoqërisë CEZ shpërndarje sh.a, në administrim të përkohshëm dhe emërimin e administratorit të shoqërisë cez shpërndarje sh.a., në zbatim të vendimit të bordit të komisionerëve të ERE nr. 4, date 21 janar 2013, “Per heqjen e licencave për aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike dhe aktivitetit të furnizimit publik me pakice të energjisë elektrike të shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a.”, Rregullores “Per procedurat e emerimit të administratorit dhe kompetencat e tij”, miratuar me Vendimin nr. 1, date 10.01.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 18.02.2013, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike të ERE,

Vendosi:

1. Miratimin e klasifikimit të personelit dhe strukturës së pagave për punonjësit e shoqërisë CEZ Shpërndarje (bashkëlidhur).
2. Deri në saktësimin e detyrimeve që CEZ Shpërndarje ka ndaj paleve të treta, fondi i pagave mos të tejkalojë realizimin faktik të vitit 2012.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Sokol RAMADANI